

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtarë, në çështjen juridike të paditësit K. J., nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson L. B., me autorizim, kundër të paditurës PTK sh.a.në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas revizionit të së paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3199/2014 datë 13.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.11.2016, mori këtë,

## A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3199/2014 datë 13.01.2016 përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të paditurës nr.01-1040-484/2012 i datës 7.03.2012, me të cilin paditësit i është zvogëluar grada e punës nga 9 në 7.

II. Revizioni i së paditurës pranohet si i themeltë përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë për pagesën e ndryshimit të pagës midis gradës 9 dhe 7, në të cilën pjesë, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3199/14 dt.13.01.2016 dhe i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1142/12 dt.15.04.2014, prishet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim.

## A r s y e t i m i

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1142/12 dt.15.04.2014, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, është anuluar aktvendimi i së paditurës nr.01-1040-484/2012 i datës 7.03.2012 dhe është detyruar e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 7 për çdo muaj, duke filluar nga dt.1.02.2012, deri në pagesën defintive, me kamatë prej 3.5% duke filluar nga data 1.02.2012 e deri në pagesën defintive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Me dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3199/14 dt.13.01.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e së paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përveç, lidhur me kamatën, në të cilën pjesë i njëjti aktgjykim është ndryshuar, ashtu që është detyruar e paditura që paditësit për shumën e gjykuar, t'i paguajë

kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit duke filluar nga data 1.02.2012 e deri në pagesën defintive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor e paditura ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulta të prishen, të refuzohet padia e paditësit ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë, në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i së paditurës është i pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se palët ndërgjyqësore, paditësi si punëmarrës dhe e paditura si punëdhënëse kanë lidhur kontratën nr.01-2880-1580/2011 dt.20.10.2011, në kohë të pacaktuar. Sipas kontratës së punës paditësi ishte caktuar zyrtarë marketingu në Departamentin e Marketingut, sipas vendimit mbi risistemimin e punëtorit nr.01-1040-484/2012 dt.7.03.2012, paditësi të e paditura caktohet në kryerjen e detyrave të punës zyrtarë marketingu në Departamentin e Marketingut, PTK. sh.a. i janë caktuar të ardhurat personale mujore në lartësi të gradës 7, sipas strukturës së gradave duke i ulë paditësit gradën nga 9 në 7. Sipas këtij vendimi lartësia e të ardhurave personale implementohet nga dt.1.02.2012 dhe se i njëjti sipas së paditurës konsiderohet pjesë përbërëse e kontratës së punës. Ky vendim i së paditurës ka ardhur pas shkresës së dt.6.12.2011 të Ministrisë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, drejtuar kryetarit të bordit të drejtorëve të paditurës, sipas së cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin 2012, duhet të jetë jo më shumë se 20%.

Në këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, anulohet vendimin kontestues të së paditurës për zvogëlimin e pagës së paditësit prej gradës 9 në 7 dhe e detyroi të paditurën që paditësit t'i paguajë diferencën sipas gradës 9 pasi që gjeti se e paditura me zvogëlimin e gradës së paditësit nga 9 në 7, në mënyrën e sipërcekur, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 par.1, pika 8 të Ligjit të Punës dhe nenit 5 të Kontratës së punës. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se marrëdhënia e punës

është marrëdhënie kontraktore që është krijuar në bazë të kushteve të punës për lidhjen e sajë,afësive kontraktuese dhe vullnetit të tyre, lëndën dhe bazën e kontratës. Palët sipas parimit të së drejtës ,me vullnetin e tyre të lirë kanë krijuar raporte reciproke juridike,të cilat mund të ndryshojnë po ashtu me vullnetin e lirë reciprok të tyre. Andaj, rrjedhë se kontrata e punës dhe kushtet e sajë nuk mund të ndryshohen në mënyrë të njëanshme nga e paditura duke cenuar të drejtat kontraktuese ligjore të paditësit, prandaj, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e së paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të sajë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko civile,pranon si të themeltë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, lidhur me aprovimin si të themeltë të kërkesëpadisë së paditësit përkritazi me anulimin e vendimit të së paditurës për zvogëlimin e gradës së punës nga 9 në 7,nga se aktgjykimet e tyre nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet e revizionit lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.2 pika n) të LPK-së. Gjykata e revizionit vlerëson se këto aktgjykime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arësytimin e tyre, arsytet e dhëna janë të kjarta, të mjaftueshme për faktet juridikishtë të vlefshme për gjykimin e drejtë të çështjes, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit, andaj, si të tilla, ato pretendime nuk janë të qëndrueshme. Poashtu, u refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera të revizionit për shkelje të dispozitave nga neni 180,nenit 190,nenit 191 etj. të LPK-së, të cilat sipas së paditurës qëndrojnë në ate se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës nuk ka mbajtur seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në të cilën është dashtë të ftohen edhe palët. Këto pretendime nga revizioni janë të paqëndrueshme, për faktin sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, kështu që duke vlerësuar edhe se në procedurën ankimore nuk janë paraqitur fakte dhe prova të reja edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka psur për obligim të mbajë seancë

gjyqësore në prezencë të palëve lidhur me ankesën e së paditurës. Kurse, qëndron fakti se në raste tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë, në kolegje të ndryshme ka marrë vendime të ndryshme, mirëpo, secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë veçanërisht (nën kushtet përkatëse ligjore) mund t'i nënshtrohet procedurës sipas mjetit të jashtzakonshëm juridik-revizionit, me ç'rast, nëpërmjet vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit evitohet vendimmarrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për çështje juridike të njëjta.

U shqyrtuan edhe pretendimet e revizionit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës. Sipas së paditurës padia e paditësit në pjesën ku është kërkuar anulimi i vendimit për uljen e gradës është e vonuar. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë nga se kontesti konkret ka të bëjë kryesisht me pagesën e diferencës së pagës për shkak të vendimit të kundërligjshëm të së paditurës për zvogëlimin e pagës, për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës afati i parashkrimit është 3 vite e jo sikundër pretendohet në revizion se afati për paraqitje të padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Veç kësaj që u sipër theksua, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qenë sipas gradës 9, prandaj, ulja e pagës nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe Ligjit të Punës. Kërkesa e aksionarit, Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, lidhur me shpenzimet e uljeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që thuhet në atë rekomandim për uljen e pagave dhe se e paditura është dashtë të paraqet një plan të detajzuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i specifikuar dhe precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e së paditurës nuk është paraqitur, andaj, nga këtu, thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Poashtu, nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të sajë lidhur me zvogëlimin e gradave dhe se nuk mund të bëhet kjo me një vendim të njëanshëm të drejtorit menagjues të së paditurës.

Ndërkohë që, aktgjykimet e lartë përmendura në pjesën gjyqësore në të cilën detyrohet e paditura që paditësit t'i paguajë ndryshimin e pagës, bonusit, trustit në mes të gradës 9 dhe 7, përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika

n) të LPK-së, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë si i tillë është i paqartë në dispozitiv dhe në kundërshtim me arësyetimin e dhënë, meqë në dispozitiv nuk është përcaktuar lartësia e këtij ndryshimi të pagës, bonusit dhe të trustit midis gradave që duhet të paguajë e paditura. Një aktgjykim i tillë nuk mund të përmbahet në mënyrë të detyrueshme (i papërshtatshëm për përmbahim-nuk janë caktuar mjetet dhe shuma, lartësia). Në këtë kontekst edhe kërkesëpadia e parregullt. Për shkak të këtyre shkeljeve thelbësore procedurale gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Në rigjykim, për këtë pjesë të kërkesëpadisë duhet të ftohet pala paditëse që të bëjë precizimin e petitumit- kërkesëpadisë dhe në lidhje me këtë pastaj gjykata e shkallës së parë të nxjerrë prova për të vërtetuar konkretisht se cila është lartësia e ndryshimit të pagës midis këtyre gradave (9 dhe 7) dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave të vendos në mënyrë meritore.

Për arsyet e sipërpërmendura dhe në pajtim me nenin 222 lidhur me nenin 223.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.306/2016 datë 21.11.2016

Kryetari kolegjit

Mr.sc.Muhamet Rexha